



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS LEPOSAVIQ

Numri i lëndës: 2023:230428

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05602523

P.nr.69/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA LEPOSAVIQ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari Xhemajl JUSUFI, në lëndën penale ndaj të pandehurve: G.M. dhe G.M.1. për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1660/23 (2023:0064832), të datës 30.10.2023, duke vendosur sipas kërkesës për shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 1660/23, e datës 30.10.2023, kjo Gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të akuzuarit:

G.M., nga i ati S., e ëma G., i lindur me datë, vendlindja Jarinjë, vendbanimi fshati Mijatoviq-Jarinjë, me numër personal, serb, shtetas i Republikës së Kosovës dhe

G.M.1., nga i ati Zh., e ëma A., e lindur me datë ..., vendlindja Guvnishte-Leposaviq, vendbanimi fshati Mijatoviq-Jarinjë, me numër personal, serbe, shtetase e Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse,

Me datë 30.09.2023, rreth orës 14.20 minuta, në fshatin Bistricë- Leposaviq, me dashje kalojnë kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës, përveç në kufirin apo vendkalimin e autorizuar kufitar dhe atë nga territori i Republikës së Serbisë, hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që deri sa Njësi Policor i NJNSH kanë qenë në vëzhgim, të njëjtit përmes kamerave kanë vërejtur automjetin “Audi” A6, ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit, të cilin e kishte

drejtuar i pandehuri G., përderisa në veturë ishte dhe e pandehura-pasagjerja G.M.1., që të njëjti janë ndaluar dhe kontrolluar.

Me këtë kanë kryer veprën penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 1, 3, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 e 140 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe neni 364 e 495 të KPP-së e:

G J Y K O N

Të pandehurin: G.M.

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 250.00 (*me fjalë: dyqind e pesëdhjetë*) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar.
- II. Obligohet i pandehuri, që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor, të paguajnë shumën prej 10 euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

Të pandehurën: G.M.1.

- IV. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 250.00 (*me fjalë: dyqind e pesëdhjetë*) euro, të cilin dënim është e obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse e pandehura nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë të papaguar.
- V. Obligohet e pandehura, që në emër të shpenzimeve procedurale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor, të paguajnë shumën prej 10 euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi
- VI. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.1660/23 të datës 30.10.2023, kundër të pandehurve G.M. dhe G.M.1., për shkak të veprës penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së dhe njëherësh, nga Gjykata ka kërkuar dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se të pandehurit vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së, që të pranohet kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe në përputhje me nenin 495 të KPP-së të jepet aktgjykimi pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se të pandehurit e kanë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së, me të cilën akuzohen të pandehurit ligjvënësi ka përcaktuar dënimin me gjobë me dyqind e pesëdhjetë (250) euro ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë fajësinë e të pandehurve se e kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkohen, sipas aktakuzës së prokurorisë dhe atë: Raporti fillestar i incidentit i datës 30.09.2023, Raporti hetimor i Policisë kufitare Regjioni i Veriut-NJHDRV-Lluzhan i datës 03.10.2023, procesverbali i marrjes në pyetje i të pandehurve i datës 30.09.2023, si dhe shkresat tjera të lëndës janë prova të besueshme të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdher ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, u bazua në nenin 140 paragrafi 1 të KPRK-së e cila dispozitë përcakton se: *“1. Kushdo që kalon kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës në cilindo vend përveç në kufirin apo vendkalimet e autorizuara kufitare, dënohet me dyqind e pesëdhjetë (250) Euro gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.”*, ndërsa pas vlerësimit të të gjitha rrethanave për matjen e dënimit, Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili përcaktohet me nenin 38 të KPRK-së, pasi që një nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se të akuzuarit do të përmbahen nga veprime të paligjshme.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sipas aktakuzës, palë të dëmtuar nuk pati.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364 e 495 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA LEPOSAVIQ

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.69/2023, datë 22.04.2024

Gjyqtari

Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala ka të drejtë kundërshtimi në afat prej 8 (tetë) ditëve, nga dita e pranimit. Kundërshtimi i parashtrohet kësaj Gjykate.